



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh II.nr.1608/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të “N.P.SH Allmakes Global Services” me NUI 810252114 me seli në “Parku i Biznesit” në Glllogoc kundër debitorit “Trepça” Sh.A me NUI 811278747 me seli në “Parku Industrial” në Mitrovicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2402/22 të datës 31.10.2023, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Trepça” Sh.A, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2402/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.2402/22 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” Sh.A me NUI 811278747 me seli në Mitrovicë i ushtruar kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.343/2022 të datës 12.10.2022 të përmbartuesit privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë që ta refuzoj ankesën e debitorit si ta pabazuar ndërsa ta vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2402/22 të datës 31.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “N.P.SH Allmakes Global Services” ka paraqitur propozim për përmbaremore me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbaremit “Trepça” Sh.a me seli në Mitrovicë t’ia paguaj shumën prej 4,337.65€ dhe shpenzimet e Propozimit për Përmbaremore në shumë prej 117.00€. Propozimin për përmbaremore e kishte bazuar në faturat me numrat dhe datat si në vijim: nr.22-SHV01-020-656 e datës 30.03.2022, nr.22-SHV01-020-658 e datës 30.03.2022, nr.22-SHV01-020-720 e datës 08.04.2022, nr.22-SHV01-020-778 e datës 13.04.2022, nr.22-SHV01-020-1147 e datës 23.05.2022, nr.22-SHV01-020-1169 e datës 25.05.2022, nr.22-SHV01-020-1291 e datës 09.06.2022, nr.22-SHV01-020-1293 e datës 09.06.2022, nr.22-SHV01-020-1506 e datës 13.07.2022, nr.22-SHV01-020-1524 e datës faqja 2 nga 4 15.07.2022, dhe nr.22-SHV01-020-1531 e datës 15.07.2022, të lëshuara nga kreditori për debitorin, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Përmbareuesi më 12.10.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbaremore P.nr.343/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbaremin sipas Propozimit.

Debitori më 26.10.2022 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka deklaruar se e kundërshton urdhrin përmbaremore për arsye se dokumentet, në bazë të cilave është marr vendimi përmbareues ose urdhri përmbareues nuk janë të përshtatshëm për përmbaremore sepse në këto fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së

detyrimin ashtu siç parashihet në nenin 27 paragrafi 1 i LPP-së. Prapësimin nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi dhe i ka kërkuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar Prapësimi dhe të lihet në fuqi Urdhri. Ai ka deklaruar se nuk pajtohet me konstatimet e Debitorit me të cilët ka pretenduar që dokumentet në bazë të cilave është marr vendimi përmbarues nuk janë të përshtatshëm për përmbarim, sepse në këto fatura i ka përmbushur të gjitha mjetet e nevojshme juridike që duhet të i përmbaj një fatura, duke përfshirë emrin e kreditorit dhe debitorit, objekti për të cilin është lëshuar ajo faturë, datën e lëshimit, shumën e detyrimit për pagesë dhe kohën e përmbushjes për detyrim, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2402/22 të datës 31.10.2023 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Trepça” Sh.a me NUI 811278747 me seli në Mitrovicë i ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.343/2022 të datës 12.10.2022 të përmbaruesit privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se faturat lëndore e përmbajnë nënshkrimin e Debitorit, që për gjykatën nënkupton se ky i fundit i ka pranuar faturat lëndore. Nga shkresat e lëndës nuk rrjedh se Debitori pas pranimin të faturave e ka kundërshtuar saktësinë e tyre, si për nga përmbajtja e shërbimeve ashtu nga detyrimi monetar, koha e përmbushjes ose ndonjë element tjetër të tyre. Prandaj, gjykata gjen se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Andaj, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se faturat në fjalë janë të nënshkruar nga ana e debitorit, andaj pranimi i të njëjtave nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga faturat po ashtu koha e përmbushjes së detyrimit monetar është paraqitur tek rubrika “data e skadimit”, data e së cilës korrespondon me datën e lëshimit të faturës, prandaj edhe konsiderohen si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbasin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh. II.nr. 1608/23, Datë:22.03.2023

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri